

**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**

**PROGRAMI FILLOR**



# **PUNIM DIPLOME**

Arta Muja

**Mitrovicë, 2018**

**UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”**

**FAKULTETI I EDUKIMIT**



# **PUNIM DIPLOME**

**NXËNËSIT ME VËSHTIRËSI NË TË  
LEXUAR NË KLASËT E PESTA NË  
MITROVICË DHE NDIKIMI I KËSAJ  
VËSHTIRËSIE NË SUKSESIN E TYRE**

**Mentorja:**

**Prof.ass.dr. Mimoza Shahini**

**Kandidatja:**

**Arta Muja**

**Mitrovicë, 2018**

**UNIVERSITY OF MITROVICA “ISA BOLETINI”**

**FACULTY OF EDUCATION**



# **DIPLOMA THESIS**

**STUDENTS WITH READING DIFFICULTIES  
IN THE FIFTH GRADE IN MITROVICA AND  
THE IMPACT OF THIS DIFFICULTY ON  
THEIR SUCCESS**

**Mentor:**

**Prof.ass.dr. Mimoza Shahini**

**Candidate:**

**Arta Muja**

**Mitrovica, 2018**

# UNIVERSITETI I MITROVICËS “ISA BOLETINI”

## FAKULTETI I EDUKIMIT

### PROGRAMI FILLOR



## PUNIM DIPLOME

**Lënda:** Psikologji edukimi

**Titulli i punimit:** Nxënësit me vështirësi në të lexuar në klasët e pesta në Mitrovicë dhe ndikimi i kësaj vështirësie në suksesin e tyre.

**Emri dhe mbiemri:** Arta Muja

**Statusi i studentit:** I rregullt

**Numri i amzës (ID Regjistri):** 1406011112

**Niveli i studimeve:** Bachelor

**Programi i studimit:** Fillor

**Mentorja e punimit:** Prof.ass.dr. Mimoza Shahini

**Aprovuar prej komisionit:**

1. \_\_\_\_\_, mentor
2. \_\_\_\_\_, anëtar
3. \_\_\_\_\_, anëtar

Data e aprovimit: \_\_\_\_\_

## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

Deklaroj se ky punim diplome me titull “Nxënësit me vështirësi në të lexuar në klasët e pesta në Mitrovicë dhe ndikimi i kësaj vështirësie në suksesin e tyre” është shkruar prej meje dhe nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe të referuara.

Për të gjitha pjesët e marra janë të vendosura referencat dhe garantoj se këtë punim nuk e kam dorëzuar për tu vlerësuar për ndonjë modul tjetër.

---

Arta Muja

## FALËNDERIME

Nuk mund të përshkruhen dot të gjitha ato që kanë ndodhur përgjatë këtyre katër viteve të studimeve, por do të ndalesha me falënderimin e disa personave të cilët nuk kursyen ndihmën e tyre për të më ndihmuar në finalizimin e studimeve.

Fillimisht, do të dëshiroja të shpreh mirënjohje edhe falënderim të veçantë mentores sime Prof.ass.dr. Mimoza Shahini për ndihmën dhe mbështetjen që më ofroi përgjatë gjithë procesit të punës për këtë temë.

Realizimi i këtij punimi nuk do të ishte i mundur pa njohuri të thella të kësaj fushe, prandaj një falënderim i veçantë i dedikohet edhe Univeritetit të Mitrovicës dhe të gjithë profesorëve të Fakultetit të Edukimit që kontribuan në formimin dhe aftësimin tim profesional.

Dëshiroj në fund të falënderoj familjen time për përkrahje maksimale që më ofroi duke bërë të mundur që të përfundoj me sukses tërë këtë rrugëtim, sa i vështirë aq edhe i bukur!

# PËRMBAJTJA

<b>1.HYRJE</b> .....	<b>1</b>
1.1. PËRKUFIZIME MBI TË LEXUARIT .....	2
1.2.VËSHIRËSIA NË TË LEXUAR .....	3
1.3.PËRQINDJET E VËSHIRËSISË NË TË LEXUAR NË VENDE TË NDRYSHME.....	5
<b>2. METODOLOGJIA</b> .....	<b>7</b>
2.1 Pjesëmarrësit.....	7
2.2 INSTRUMENTI .....	8
2.3 MËNYRA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE .....	9
2.4 ANALIZAT .....	9
2.5 ASPEKTI ETIK .....	9
2.6.KUFIZIMET E HULUMTIMIT .....	10
<b>3. REZULTATE</b> .....	<b>11</b>
<b>4. DISKUTIME</b> .....	<b>25</b>
<b>5. PËRFUNDIME</b> .....	<b>27</b>
<b>LITERATURA</b> .....	<b>29</b>
<b>SHTOJCAT</b> .....	<b>33</b>
SHTOJCA A .....	33
SHTOJCA B.....	34

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Numri dhe përqindja e pjesëmarrësve sipas shkollave të përfshira në hulumtim.....	8
Tabela 2. Besueshmëria e pyetësorit.....	8
Tabela 3. Analiza korrelacionare mes variablave “A e ka të vështirë të gjejë fjalët e duhur për t’u shprehur?” dhe “Kur shkruan a e ka të vështirë t’i organizojë mendimet në letër?”.....	21
Tabela 4. Analiza korrelacionare mes variablave “A i ngatërron rreshtat gjatë leximit?” dhe “A i rilexon paragrafët për t’i kuptuar ato më mirë?”.....	22
Tabela 5. Analiza korrelacionare mes variablave “Sa vështirë e ka të recitojë alfabetin?” dhe “A e ka të vështirë të lexojë zëshëm?”.....	22
Tabela 6. Analiza korrelacionare mes variablave “A ka pengesa në tregim të drejtimit majtas dhe djathtas?” dhe “A ndihet i habitur duke lexuar udhëzimet e hartës?”.....	23
Tabela 7. Analiza korrelacionare mes variablave “A i ngatërron fjalët e ngjashme vizuale si ditë dhe datë?” dhe “A i ngatërron emrat e objekteve si psh tavolinë në vend të karrigës?”.....	24



## LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Përqindja e fëmijëve pa vështirësi dhe me vështirësi në të lexuar sipas gjinisë.....	10
Figura 2. Përqindja e fëmijëve pjesëmarrës sipas vendbanimit dhe gjinisë.....	12
Figura 3. A i ngatërron fjalët e ngjashme vizuale si ditë dhe datë? .....	12
Figura 4. A i ngatërron rreshtat gjatë leximit?.....	13
Figura 5. A i ngatërron emrat e objekteve si p.sh tavolinë në vend të karrigës?.....	13
Figura 6. A ka pengesë në tregim të drejtimit majtas dhe djathtas?.....	14
Figura 7. A ndihet i habitur duke lexuar udhëzimet e hartës?.....	14
Figura 8. A i rilexon paragrafët për t'i kuptuar ato më mirë?.....	15
Figura 9. A ndihet i hutuar gjatë dhënies së disa informatave përnjëherë?.....	15
Figura 10. A bën gabime kur merr porosi nga telefoni?.....	16
Figura 11. A e ka të vështirë të gjejë fjalët e duhura për t'u shprehur?.....	16
Figura 12. Sa shpesh mendon për zgjidhje kreative të problemit?.....	17
Figura 13. Sa e ka të vështirë të shqiptojë fjalën E-le-fant?.....	17
Figura 14. Kur shkruan a e ka të vështirë të organizojë mendimet e tij në letër?.....	18
Figura 15. A ka mësuar tabelën e shumëzimit lehtësisht?.....	18
Figura 16. Sa vështirë e ka të recitojë alfabetin?.....	19
Figura 17. Sa vështirë e ka të lexojë zëshëm?.....	19
Figura 18. Suksesi i përgjithshëm i fëmijëve në tri lëndët kryesore.....	20
Figura 19. Suksesi i fëmijëve me vështirësi në tri lëndët kryesore.....	20

## LISTA E SHKURTESAVE

DKA.....	DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
SH.F.M.U.....	SHKOLLA FILLORE E MESME E ULËT

## ABSTRAKTI

Të lexuarit është proces mjaft i rëndësishëm që konsiderohet komponent kryesor në procesin e të nxënësve, i cili na ndjek gjatë gjithë jetës tonë. Ai përveç se kërkon identifikimin e fjalëve të shtypura ngërthen në vete edhe një kërkesë kyçe që është nocioni i të kuptuarit, pra marrjen dhe ndërtimin e kuptimit nga ana e lexuesit. Të lexosh është aftësi, e që fatkeqësisht nuk zhvillohet tek secili individ. Shumë prej tyre kanë vështirësi në të lexuar ose siç njihet ndryshe me termin disleksi. Ajo manifestohet me vështirësi në identifikimin dhe njohjen e tingujve, shkronjave, fjalëve, shqiptimin dhe shkrimin e tyre, e ndonjëherë edhe me vështirësi që lidhen me njohuritë aritmetike.

Qëllimi i këtij hulumtimi është identifikimi i nxënësve me vështirësi në të lexuar në klasët e pesta në komunën e Mitrovicës si dhe ndikimi i kësaj vështirësie në suksesin e nxënësve. Kjo është mundësuar përmes mbledhjes, organizimit dhe vlerësimit të të dhënave nga puna në terren deri në arritjen e përfundimeve dhe përcaktimin nëse përputhen apo jo hipotezat e formuluarat.

Hulumtimi ka qasje kuantitative dhe për mostër janë marrë 316 nxënës të klasëve të pesta në regjionin e Mitrovicës me metodën e rastësishme. Instrumenti i përdorur për mbledhjen e të dhënave është një pyetësor i adaptuar nga Ian Smythe and John Everatt 2001, për disleksinë me leje përdorimi nga të gjithë.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se nga gjithsej 316 fëmijë që kanë marrë pjesë në hulumtim 12.34% e tyre kanë vështirësi në të lexuar. Prej tyre 33.33% janë femra dhe 66.66% janë meshkuj, nga fshati janë 38.47% kurse nga qyteti 61.52%. Ndërsa rezultatet nga sukcesi në tri lëndët kryesore tregojnë se 7.4% e nxënësve me vështirësi në të lexuar janë të shkëlqyeshëm (5), 13.2% janë vlerësuar me shumë mirë (4), 36.6% mirë (3), 34.6% mjaftueshëm (2) dhe me sukses të pamjaftueshëm 8.3% (1).

Rezultatet e hulumtimit tregojnë që 12.34% e fëmijëve kanë probleme të fushës disleksike ndërsa një hulumtim i kryer në Amerikë tregon se rreth 20% e fëmijëve kanë probleme si disleksia apo disgrafia.

***Fjalët kyçe:*** Leximi, vështirësi, sukcesi, Mitrovicë

## ABSTRACT

Reading is a very important process that is considered a major component in the learning process, which follows us throughout our lives. Except that requires the identification of printed words, it also entails a key requirement that is the notion of meaning, which means receiving, understanding and building the meaning from the reader. Reading is a skill, and this unfortunately does not develop to each individual. Many of them have reading difficulties or otherwise known as dyslexia. It is manifested with difficulty in identifying and recognizing sounds, letters, words, pronunciation and writing them, and sometimes even with difficulties related to the arithmetic knowledge.

The purpose of this research is to identify students with reading difficulties in fifth grades in the municipality of Mitrovica and to know the impact of this difficulty on their success. This is made possible by collecting, organizing and evaluating data from field work to the conclusion of the findings and determining whether or not the formulated hypotheses are matched.

The research has a quantitative approach and for the sample are taken 316 students of the fifth grade in the Mitrovica by the random method. The instrument used for data collection is a questionnaire adapted from Ian Smythe and John Everatt 2001, for dyslexia with the use permission for all.

The research results show that from 316 children who participated in the research, 12.34% of them have reading difficulty. 33.33% are females and 66.66% males, while from the village are 38.47% and from the city 61.52% of them. While the results from success in the three main subjects show that 7.4% of students with reading difficulties are excellent (5), 13.2% are rated very well (4), 36.6% good (3), 34.6% enough (2) and with insufficient success 8.3% (1).

Research findings show that 12.34% of children have problems of the dyslexic field, while a research in America shows that around 20% of children have problems like dyslexia or dysgraphia.

**Key words:** Reading, difficulty, success, Mitrovica

## 1. HYRJE

Duke marrë parasysh kohën e teknologjisë të cilën po e jetojmë, të lexuarit bëhet pjesë integrale mjaft e rëndësishme dhe kryesore e jetës sonë pasi që secili prej nesh përgjatë ditës lexon të paktën një rresht. Leximi i shënimeve, artikujve, lajmeve, librave e shumë informatave tjera janë disa nga arsyet pse të lexuarit është shumë i rëndësishëm (Graham & Harris, 2000). Nevoja për të pasur aftësi dhe rrjedhshmëri në të lexuar është me rëndësi të madhe në shoqërinë e sotme (Crouch & Jakubecy, 2007). Interpretimi i ideve, leximi apo nënshkrimi i marrëveshjeve ligjore dhe të tjera aktivitete të përditshme kanë rëndësi të madhe në ditët e sotme ndaj si pasojë është i nevojshëm zotërimi i aftësisë për të lexuar.

Në jetën e përditshme për të lexuarit shpesh dëgjojmë shprehjet: është diell i dijes, sjell emancipimin, mundëson zhvillimin e mendjes, është hallkë e rëndësishme në procesin e njohjes dhe të nxënies, transmeton vlerat e shoqërisë njerëzore dhe është proces që na ndjek gjatë gjithë jetës (Andersson, 2003). Mund të themi se krahas të dëgjuarit, të folurit dhe të shkruarit, edhe të lexuarit është një burim kryesor njohurish dhe mjet komunikimi.

Të lexuarit është një proces i rëndësishëm intelektual dhe edukativ që mundëson realizimin e shumë marrëdhënieve komunikative mes njerëzve (Gjokutaj, 2014). Të lexosh mund të duket një gjë e thjeshtë dhe elementare, pasi që shumë njerëz besojnë se aftësia për të lexuar merret qysh me fillimet e jetës së tyre arsimore, por ka një dallim të dukshëm në mes të lexuarit fizikisht dhe të lexuarit mendërisht. Ai përveç se është proces i identifikimit të fjalëve të shtypura ngërthen në vete edhe nocionin e të kuptuarit, pra marrjen dhe ndërtimit e kuptimit nga ana e lexuesit (Meece & Daniels, 2008).

Dija që përfitohet nga të lexuarit pasuron fjalorin, të shprehurit, idetë, imagjinatën dhe krijon tek një person aftësi të qëndrueshme për të folur. Përvetësimi i fjalëve të reja dhe njohja me kuptimet e tyre është një nga rrugët më të rëndësishme për zhvillimin e të folurit dhe zotërimin e gjuhës si mjet kyç i komunikimit. Shkolla, si institucion përmes të cilit përcillen dhe përvetësohen dije, e sheh të lexuarin si çelësin e sukseseve të çdo individi në të gjitha moshat e edukimit të tij. Si i tillë është konsideruar parakusht për arritjet e mëvonshme akademike (Graham & Harris, 2000).

Për fat të keq jo tek të gjithë zhvillohet aftësia e të lexuarit në nivelin e dëshiruar. Shumë nxënës kanë vështirësi në të lexuar apo siç njihet ndryshe me termin disleksi. Kur flasim për disleksinë nënkuptojmë individë që kanë vështirësi në identifikimin dhe njohjen e tingujve, shkronjave, fjalëve, shqiptimin dhe shkrimin e tyre, e ndonjëherë edhe me vështirësi që lidhen me njohuritë aritmetike (Moats & Dakin, 2008). Aftësi e kufizuar për të mësuar të lexuarit, është kur fëmija ka një nivel të aftësisë nën atë që pritet për moshën kronologjike, mendore dhe nivelin arsimor.

Duke u bazuar në praktikën e mbajtur, gjatë punës me nxënës vura re se nxënësit kishin vështirësi të lexonin qoftë edhe një rresht të vetëm pa gabime, ndaj nga kjo zgjohet kureshtja për të gërmuar më tej për të parë se sa ka nxënës me vështirësi në të lexuar në klasët e pesta në komunën e Mitrovicës si dhe ndikimin e kësaj vështirësie në suksesin e nxënësve.

### ***1.1. Përkufizime mbi të lexuarit***

Të lexuarit është një proces i rëndësishëm intelektual dhe edukativ që mundëson realizimin e shumë marrëdhënieve komunikative mes njerëzve (Gjokutaj, 2014). Ai nënkupton identifikimin e fjalëve të shtypura që ngërthen në vete nocionin e të kuptuarit, pra marrjen dhe ndërtimit e kuptimit nga ana e lexuesit (Meece & Daniels, 2008).

Në jetën e përditshme për të lexuarit shpesh dëgjojmë shprehjet: është diell i dijes, sjell emancipimin, mundëson zhvillimin e mendjes, është hallkë e rëndësishme në procesin e njohjes dhe të nxënimit, transmeton vlerat e shoqërisë njerëzore dhe është proces që na ndjek gjatë gjithë jetës (Andersson, 2003). Mund të themi se krahas të dëgjuarit, të folurit dhe të shkruarit, edhe të lexuarit është një burim kryesor njohurish dhe mjet komunikimi.

Të lexuarit është një aftësi komplekse që kërkon mësim formal dhe elementar në tre vitet e para të shkollës fillore. Ai është më shumë se vetëm një akt motorik, është një proces njohës për zhvillimin e aftësive në përgjithësi (Abbott, Berninger & Fayol, 2010).

Sipas Borel Masonny (1949) “të lexosh do të thotë që shenjës së shkruar t’i gjendet sonoriteti i tij” (Gjokutaj, 2014). Një tjetër përkufizim vie nga Gaston Mialaret (1887) i cili e përkufizon të lexuarit në këtë mënyrë: “Të dish të lexosh, do të thotë të jesh i

aftë ta transformosh një mesazh të shkruar në një mesazh sonor (tingullor) duke ndjekur disa rregulla të përcaktuara, të kuptosh përmbajtjen e mesazhit të shkruar, si dhe të gjykosësh dhe vlerësosh vlerat estetike” (Gjokutaj, 2014).

Në lidhje me të lexuarit dhe përkufizimet rreth tij janë mbajtur qëndrime të ndryshme. Por një gjë është e sigurt, duke marrë parasysh kohën e teknologjisë të cilën po e jetojmë, të lexuarit bëhet pjesë integrale mjaft e rëndësishme dhe kryesore e jetës sonë. Të lexuarit konsiderohet hallkë e rëndësishme në procesin e të nxënës, i cili na ndjek gjatë gjithë jetës. Leximi i shënimeve, artikujve, lajmeve, librave e shumë informatave tjera janë disa nga arsyet pse të lexuarit është shumë i rëndësishëm (Graham & Harris, 2000).

### ***1.2. Vështirësia në të lexuar***

Shumë nxënës kanë vështirësi në të lexuar apo siç njihet ndryshe me termin disleksi. Fëmija me këtë vështirësi ka probleme në njohjen, kuptimin dhe formulimin e asaj që lexon, asaj çfarë thonë të tjerët apo edhe në ato që vet fëmija i thotë (Burden, 2005). Kemi të bëjmë me vështirësi në identifikimin dhe njohjen e tingujve, shkronjave, fjalëve, shqiptimin dhe shkrimin e tyre, e ndonjëherë edhe me vështirësi që lidhen me njohuritë aritmetike (Moats & Dakin, 2008).

Disleksia nuk është sëmundje por një gjendje neurologjike apo çrregullim me bazë gjenetike (Richards, 2000). Një e katërta e të gjithë fëmijëve me disleksi kanë një prind të prekur nga ky çrregullim, ndërsa fëmijët që i kanë të dy prindërit e prekur, kanë akoma më tepër mundësi ta shfaqin atë (Humphrey, 2002).

Disleksia përveç se një disavantazh njohës, konsiderohet gjithashtu një disavantazh social (Harrison, Rosenblum & Currie, 2010). Kjo ngase mund të ndikojë në mënyrën se si fëmija ndërvepron në shkollë, në familje dhe shoqëri. Këta fëmijë ndërveprojnë më pak me moshatarët e tyre krahas fëmijëve tjerë që nuk i kanë këto vështirësi, për shkak të frustrimit që buron nga pamundësia për të komunikuar lirshëm me të tjerët (Cortiella & Horowitz, 2014). Përveç kësaj ata mund të ndihen edhe të turpëruar shkak i kësaj pengese që kanë. Burden (2005) e ka paraqitur këtë me anë të fragmenteve nga intervistat e bëra me disleksikët e rinj, duke i vënë theks të veçantë mbylljes në vete, frustrimit dhe mungesës së vetëbesimit nga turpi që ndjejnë këta fëmijë në vitet e para të shkollës, e sidomos djemtë. Fëmija ndjen se diçka nuk është

në rregull me të, por ndihet i hutuar për atë se çfarë mund të jetë (McNulty, 2003). Në të shumtën e rasteve kjo gjendje mendore mund të zgjasë me vite, deri në momentin kur vërtetohet se kemi të bëjmë me disleksi.

Fëmijët e shkollave fillore zakonisht shpenzojnë deri në 50% të kohës në shkollë të angazhuar në detyra që kërkojnë të lexuar, disa prej të cilave duhet të përfundojnë në kohë të kufizuar (Tseng & Chow, 2000). E poashtu duke marrë parasysh se burim kryesor i procesit mësimor janë tekstet shkollore, të lexuarit është pjesë e pandashme e tij. Si pasojë e kësaj fëmijët me vështirësi në të lexuar mund të kenë ngecje në mbarimin e detyrave me kohë që shkakton mangësi në të mësuar e kjo gjë patjetër që ndikon edhe në suksesin e tyre. Pra, disleksia mund të ketë efekte negative në suksesin e një nxënësi në shkollë (Humphrey & Mullins, 2002). Këtë e pohon edhe Ridsdale (2004). Ata mund të mësojnë shumë më pak nga një detyrë sepse ju duhet të përqendrohen në të lexuar në vend se të kuptojnë përmbajtjen e saj. Pasi që kalojnë më shumë kohë në një detyrë sesa moshatarët e tyre, këta nxënës kuptojnë më pak thelbin e detyrës. Nuk është çudi, nëse ata humbasin vetëbesimin dhe vuajnë nga paaftësia për të mësuar kur të lexuarit është pengesa e tyre kryesore (Jones, 2015). Një nxënës i cili nuk zotëron mirë të lexuarin ka më pak mundësi të ketë arritje në lëndët e tjera mësimore.

Të lexuarit ndikon në të kuptuarit e ushtrimeve dhe teksteve matematikore si dhe aftësive për të zgjidhur probleme të ndryshme në matematikë. Poashtu kuptimi ose analiza e teksteve të shkencave të natyrës kërkon aftësi të mira leximi. Disleksia shpesh mbivendoset me aftësi të kufizuara të të mësuarit si dëmtimi i të folurit, çrregullimi i deficitit të vëmendjes ose çrregullimi i koordinimit zhvillimor (Marentette, 2011). Duket se aftësia e dobët mund të ndikojë në perceptimet rreth kompetencave të të shprehurit, ku bëjnë pjesë edhe leximi e shkrimi (Graham & Harris, 2000).

Disleksia, e njohur si vështirësia në të lexuar është një nga problemet arsimore më të përhapura dhe fatkeqësisht më pak të njohura në shkolla (Mathes & Fletcher, 2008). Zbulimi i vështirësisë në të lexuar është shumë me rëndësi të bëhet në moshë sa më të hershme, në mënyrë që fëmijët të marrin ndihmën e nevojshme ose udhëzime të specializuara në këtë drejtim, në të gjitha aftësitë përkatëse që ndërhyjnë në mësimin e tyre të shprehjes (Martin, Foels, Clanton & Moon, 2004). Është gjithashtu e rëndësishme për të përcaktuar nëse një fëmijë me disleksi mund të ketë gjithashtu

disgrafi dhe të kërkojë ndihmë të veçantë për lexim dhe shkrim (Wright & Wright 2008).

Ata që kanë këto vështirësi shumë herë mbesin të pidentifikuar nëse nuk kanë probleme shumë të dukshme, ngase etiketohen si "mendërisht prapa" ose "nuk janë të interesuar për të lexuar" (Jones, 2015). Prindërit e sidomos mësimit të leximit luajnë rol kyç në procesin e identifikimit të disleksisë tek fëmijët dhe nxënësit e tyre ndaj ata duhet të jenë të informuar rreth kësaj vështirësie që të mund tu japin mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme atyre (Tunmer & Greaney, 2010). Kjo është natyrisht e dëshirueshme, për arsye se nuk është vonë gjatë viteve të moshës shkollore për të ndërhyrë në përmirësimin e aftësive të mangëta të nxënësit duke i siguruar atyre mjedis të përshtatshëm. Roli i mësimit të leximit konsiston në gjetjen e rrugëve të duhura për të rritur cilësinë dhe performancën e çdo nxënësi pavarësisht vështirësive që hasin. Që të arrihet kjo mësimit të leximit kanë nevojë për trajnim për të adresuar nevojat e veçanta të nxënësve (Rajakumar & Hema, 2005).

### ***1.3.Përqindjet e vështirësisë në të lexuar në vende të ndryshme***

Studime të shumta të kryera për përqindjen e vështirësisë në të lexuar në vende të ndryshme të botës raportojnë përqindje të larta apo të ulëta. Ende nuk dihet se sa njerëz kanë probleme disleksike mirëpo sipas hulumtimeve përqindja varion nga 5 deri në 21% (Jones, 2015). Një hulumtim i kryer në Amerikë tregon se rreth 20% e fëmijëve kanë probleme si disleksia apo disgrafia (Richards, Grabowski, Boord, Yagle, Askren, Mestre, Robinson, Welker, Gulliford, Nagy & Berninger, 2015). Numri i fëmijëve të prekur me disleksi në shkollat fillore në Indi është raportuar të jetë 2-18% (Mogasale, Patil, Patil & Mogasale, 2012). Në një hulumtim të kryer në Jaipur të Indisë në shkollat fillore ku si mostër janë marrë 668 djem dhe 488 vajza prej 6 deri në 13 vjeç rreth 20% e fëmijëve kanë pasur probleme me leximin (Dhanda & Jagawat, 2013).

Të lexuarit është një proces i vështirë për 10-30% të fëmijëve në shkollat fillore (Rosenblum, Weiss & Parush, 2004). Për fat të keq, vështirësitë në të lexuar zakonisht vërehen tek fëmijët në shkollat fillore, veçanërisht tek djemtë (Feder & Majnemer, 2007). Se djemtë janë më të prekur se vajzat me disleksi dhe disgrafi, tregohet edhe në 2013 ku 9% e djemve dhe 6% e vajzave nga 3 deri në 17 vjeç rezultuan të kenë probleme të fushës së disleksisë apo disgrafisë (Jones, 2015). Sipas një hulumtimi të



kryer në Greqi nga 598 nxënës pjesëmarrës, 7.6% prej tyre kanë qenë meshkuj dhe 3.8% femra (Vlachos, Avramidis, Dedousis, Ntalla & Giannakopoulou, 2013). Një e katërta e të gjithë fëmijëve me disleksi kanë një prind të prekur nga ky çrregullim, ndërsa fëmijët që i kanë të dy prindërit e prekur, kanë akoma më tepër mundësi ta shfaqin atë (Humphrey, 2002). Mendohet se India ka përafërsisht nëntëdhjetë milionë njerëz me shkallë të ndryshme të aftësive të kufizuara në mësim dhe një klasë mesatare në shkollë ka rreth pesë nxënës me aftësi të kufizuara të të mësuarit (Mogasale, Patil, Patil & Mogasale, 2012).

Të lexuarit është një aftësi komplekse që kërkon mësim formal dhe elementar në tre vitet e para të shkollës fillore. Ai është më shumë se vetëm një akt motorik, është një proces njohës për zhvillimin e aftësive në përgjithësi (Abbott, Berninger & Fayol, 2010). Vështirësitë në të lexuar mund të errësojnë aftësitë e fëmijës në fusha të tjera, duke e bërë suksesin e tyre në shkollë më të dobët dhe më të vështirë për ta arritur. Fëmijët me probleme të tilla zakonisht kanë vështirësi për të fituar njohuritë e nevojshme dhe për të kryer detyrat gjatë viteve të shkollës fillore, të cilat mund të pengojnë progresin akademik, të shkaktojë ulje të vetëbesimit dhe probleme me sjelljen (Shaley, Auerbach, Manor & Gross-Tsur, 2000).

Numri i fëmijëve të prekur me disleksi në shkollat fillore në Indi është raportuar të jetë 2-18%. Prevalenca specifike e aftësisë për të mësuar ishte 15.17%, ndërsa 12.5%, 11.2% dhe 10.5% kishin disgrafi, disleksi dhe diskalkuli (Mogasale, Patil, Patil & Mogasale, 2012).

## 2. METODOLOGJIA

Hulumtimi “Nxënësit me vështirësi në të lexuar në klasët e pesta në Mitrovicë dhe ndikimi i kësaj vështirësie në suksesin e tyre” ka qasje kuantitative (sasiore). Qëllimi i këtij hulumtimi është identifikimi i nxënësve me vështirësi në të lexuar në klasët e pesta në komunën e Mitrovicës si dhe të kuptohet ndikimi i kësaj vështirësie në suksesin akademik të nxënësve. Të dihet se cila gjini është më e prekur, si dhe a vlerësohen me nota më të ulëta nxënësit që kanë këtë vështirësi.

Hulumtimi është specifikuar në bazë të disa pyetjeve të cilat kanë ndihmuar në formulimin e hipotezave:

P1: Cila është prevalenca e vështirësisë në të lexuar në shkollat fillore në Mitrovicë?

H1: Në klasët e V-ta të shkollave të Mitrovicës ka nxënës me vështirësi në të lexuar

P2: A ka dallime gjinore në vështirësitë në të lexuar?

H1: Djemtë janë më të prekur se vajzat me këtë vështirësi

P3: Cila është lidhshmëria e vështirësisë në të lexuar me suksesin në shkollë?

H3: Vështirësia në të lexuar ndikon në suksesin e nxënësve në shkollë

### 2.1 Pjesëmarrësit

Në komunën e Mitrovicës janë gjithsej 36 institucione arsimore (SH.F.M.U), ku prej tyre 14 në zonën urbane dhe 23 në zonën rurale (DKA, 2018). Ky hulumtim ka popullatë të gjithë nxënësit e klasëve të pesta në shkollat e Mitrovicës që gjithsej janë 1160 nxënës (DKA, 2018). Mostra për këtë hulumtim është zgjedhur në mënyrë të rastësishme. Janë përfshirë të gjithë nxënësit e klasëve të pesta të gjashtë shkollave të komunës së Mitrovicës, 3 shkolla nga qyteti dhe 3 nga fshati. Nga 316 nxënës sa janë gjithsej, 76.89% janë nga qyteti kurse 23.10% nga fshati. Femra janë 51.6% kurse meshkuj 48.4%. Moshë e pjesëmarrësve është 10-11 vjeç.

Shkollat e zgjedhura me anë të mostrës së rastësishme ishin:

Shkollat në qytet:

1. SH.F.M.U. Ismail Qemali
2. SH.F.M.U. Andon Zako Çajupi
3. SH.F.M.U. Eqrem Çabej

Shkollat në fshatra:

1. SH.F.M.U. Jusuf Rexha - Koshtovë
2. SH.F.M.U. Mehë Uka - Bajgorë
3. SH.F.M.U. Xhevat Isufi - Bare

Në tabelën 1 është paraqitur numri i përgjithshëm i nxënësve të klasës së pestë si dhe përqindja e tyre sipas shkollave të përfshira në këtë hulumtim.

Tabela 1.

*Numri dhe përqindja e pjesëmarrësve sipas shkollave të përfshira në hulumtim*

	<i>Numri</i>	<i>Përqindja</i>	<i>Përqindja valide</i>	<i>Përqindja kumulative</i>
Ismail Qemali	66	20.9	20.9	20.9
Andon Zako Çajupi	44	13.9	13.9	34.8
Eqrem Çabej	133	42.1	42.1	76.9
Jusuf Rexha	34	10.8	10.8	87.7
Mehë Uka	18	5.7	5.7	93.4
Xhevat Isufi	21	6.6	6.6	100.0
Gjithsej	316	100.0	100.0	

## **2.2 Instrumenti**

Instrumenti i përdorur për mbledhjen e të dhënave është një pyetësor i adaptuar nga Ian Smythe and John Everatt 2001, për shqyrtimin e aftësisë në të lexuar me të drejtë përdorimi nga të gjithë. Pyetësori përmban të dhëna demografike si vendbanimi (fshat-qytet), klasa, shkolla dhe ka gjithsej 15 pyetje ku cilës pyetje i është përcaktuar numri i pikëve. Nxënësi i cili ka 0-39 pikë do të thotë që nuk ka vështirësi në të lexuar, ndërsa nxënësi me mbi 39 pikë ka vështirësi në të lexuar. Ndërsa kur flasim për besueshmërinë e pyetësorit të përdorur rezultatet e këtij studimi tregojnë se pyetësori i përbërë prej 15 pyetjeve është i besueshëm ( $\varphi = .856$ ), e kjo është paraqitur përmes tabelës 2.

Tabela 2.

*Besueshmëria e pyetësorit*

Cronbach's alpha	Cronbach's alpha e bazuar në pyetjet e standardizuara	Numri i pyetjeve
.856	.869	15

Për të matur ndikimin që ka vështirësia në të lexuar në suksesin e nxënësve është marrë sukcesi i nxënësve në tri lëndët kryesore: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Njeriu dhe natyra.

### ***2.3 Mënyra e mbledhjes së të dhënave***

Para se respondentët të rekrutohen në këtë hulumtim është marrë leja nga Drejtoria e Arsimit në komunën e Mitrovicës për hulumtim si dhe pëlqimi i drejtorëve të shkollave përkatëse. Respondentët (mësimdhënësit) janë njoftuar me qëllimin e hulumtimit e më pas atyre u janë ofruar të gjitha udhëzimet e nevojshme për mënyrën e plotësimit të pyetësorit. Të gjithë pyetësorët janë plotësuar, që nënkupton se nuk kemi pasur asnjë mungesë. Gjithashtu është marrë edhe sukcesi i nxënësve në tri lëndët kryesore: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Njeriu dhe natyra.

### ***2.4 Analizat***

Revolucioni global i teknologjisë ka bërë që të përsosen metodat e kërkimit dhe analizimit të të dhënave. Në këtë rast me ndihmën e paketës statistikore SPSS janë analizuar përgjigjet e pranuar nga pyetësori i përdorur për këtë hulumtim të cilat janë analizuar në tërësi, me ç'rast më pas janë gjetur frekuencat, janë bërë korelacionet gjatë analizimit të të dhënave përmes analizës korrelacionale të Pearson-it e cila tregon ndërlidhjen signifikante në mes variablave të ndryshme dhe T-testi.

### ***2.5 Aspekti etik***

Një gjë mjaft e rëndësishme përgjatë gjithë këtij procesi ishte edhe respektimi i etikës hulumtuese, të cilës i është kushtuar rëndësi e veçantë. Para së gjithash duhet të jemi të kujdesshëm që të mos i cenojmë të drejtat e individëve të përfshirë në hulumtim, ndaj edhe ky punim është mbështetur në rregulla të etikës. Pjesëmarrësve të përfshirë në hulumtim u është treguar se hulumtimi realizohet vetëm për qëllim studimi dhe për asnjë qëllim tjetër. Ata janë siguruar që të dhënat e tyre do jenë konfidente dhe në asnjë mënyrë nuk do të lejohet reklamimi i tyre. Pjesëmarrja e tyre ishte vullnetare, pra asnjëri nuk qe i detyruar të përfshihet në këtë hulumtim.

## ***2.6.Kufizimet e hulumtimit***

Sikurse çdo hulumtim tjetër edhe ky hulumtim ka kufizimet e tij. Në të janë përfshirë vetëm gjashtë shkolla të komunës së Mitrovicës që krahasuar me numrin në total të shkollave që gjenden në Mitrovicë është mostër e vogël. Një mostër e përbërë nga një numër më i madh i shkollave do të jepte padyshim rezultate më të besueshme.


Ky hulumtim nuk është mbështetur në mendimet e nxënësve pasi që respondentë kanë qenë mësimdhënësit, përfshirja edhe e nxënësve do ta pasuronte akoma më tepër këtë hulumtim. Poashtu pyetjet në pyetësorin e përdorur ishin të tipit të mbyllur që në njëfarë mënyre kanë kufizuar përgjigjet e pjesëmarrësve, e zëvendësimi i tyre me pyetje të hapura do të ofronte më shumë mundësi shprehjeje.

### 3. REZULTATE

Kapitulli i rezultateve është pothuajse pjesa më e rëndësishme e hulumtimit, ngase këtu paraqiten në mënyrë logjike gjetjet e hulumtimit të bërë të cilat jepen në formë përshkruese të shoqëruara me tabela dhe figura duke mbështetur dhe përforcuar shpjegimin e tyre.

Pyetësi i përdorur për hulumtimin “Nxënësit me vështirësi në të lexuar në klasët e pesta në Mitrovicë dhe ndikimi i kësaj vështirësie në suksesin e tyre” ka synuar të grumbullojë informacionet e nevojshme lidhur me temën. Pas përdorimit të metodave dhe realizimit të punës në terren, kemi arritur të gjetjet të cilat do të prezantojmë në vazhdim.

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se 39 fëmijë (12.34%) nga gjithsej 316 sa kanë marrë pjesë në hulumtim kanë probleme serioze me të lexuarit. Nga 12.34% e fëmijëve 8.23% janë meshkuj dhe 4.11% femra. Pjesa tjetër prej 87.64% nuk kanë probleme me të lexuarit (47.46% femra dhe 40.18% meshkuj).



*Figura 1. Përqindja e fëmijëve pa vështirësi dhe me vështirësi në të lexuar sipas gjinisë*

Nëse merret për bazë vendbanimi i fëmijëve pjesëmarrës në hulumtim dhe gjinia e tyre atëherë rezultatet janë si vijon: 79.90% (243 fëmijë) janë nga qyteti ku prej tyre femra janë gjithsej 129 ose 40.83% dhe meshkuj 114 ose 36.07%, kurse 73 fëmijë ose

23.10% nga fshati duke përfshirë 10.76% femra dhe 12.34% meshkuj ose thënë ndryshe 34 femra e 39 meshkuj.




Figura 2. Përqindja e fëmijëve pjesëmarrës sipas vendbanimit dhe gjinisë

Rezultatet nga ky studim tregojnë se 78.5% e fëmijëve rallë ngatërrojnë fjalët e ngjashme vizuale si ditë dhe datë, ndonjëherë 12.0%, 6.3% e tyre shpesh dhe 3.2% shumicën e kohës.

Nga të gjithë fëmijët pjesëmarrës 67.1% rallë i ngatërrojnë rreshtat gjatë leximit, 18.4% ndonjëherë, 9.8% shpesh, kurse 4.7% nga ta shumicën e kohës.






Figura 3. A i ngatërrojnë fjalët e ngjashme vizuale si ditë dhe datë?



*Figura 4. A i ngatërron rreshtat gjatë leximit?*

Në pyetjen se a i ngatërron emrat e objekteve si p.sh Tavolinë në vend të karrigës, përqindja është si vijon: 68.0% rrallë, ndonjëherë 20.6%, shpesh 8.2% dhe shumicën e kohës 3.2%.




*Figura 5. A i ngatërron emrat e objekteve si p.sh tavolinë në vend të karrigës?*




Pengesë në tregim të drejtimit majtas dhe djathtas kanë rrallë 41.5% e fëmijëve, ndonjëherë 32.6%, shpesh 14.2% dhe shumicën e kohës 11.7%.

57.0% e këtyre fëmijë rezulton se rrallë ndihen të habitur duke lexuar udhëzimet e hartës, ndonjëherë 23.7%, shpesh 10.1% dhe shumicën e kohës 9.2%.



*Figura 6.* A ka pengesa në tregim të drejtimit majtas dhe djathtas?



*Figura 7.* A ndihet i habitur duke lexuar udhëzimet e hartës?

Nga 316 fëmijët sa janë përfshirë në studim 58.2% e tyre rrallë rilexojnë paragrafët për t'i kuptuar më mirë, 20.3% ndonjëherë, 7.9% shpesh dhe 13.6% shumicën e kohës i rilexojnë ato.

60.8% e fëmijëve rrallë ndihet të hutuar kur marrin disa informata përnjëherë, 19.3% ndonjëherë, shpesh 10.1% dhe shumicën e kohës 9.8% e tyre.




Figura 8. A i rilexon paragrafët për t'i kuptuar ato më mirë?




Figura 9. A ndihet i habitur gjatë dhënies së disa informatave përnjëherë?

Nga fëmijët pjesëmarrës 68.4% rrallë gabojnë kur marrin porosi nga telefoni, 26.3% ndonjëherë, 2.5% shpesh dhe 2.8% gabojnë shumicën e kohës.

Afërsisht 53.6% e fëmijëve rrallë herë e kanë të vështirë të gjejnë fjalët e duhura për t'u shprehur, 19.9% ndonjëherë, 9.8% shpesh dhe 13.9% hasin këtë vështirësi.

Pyetja “Sa shpesh mendon për zgjidhje kreative të problemit” jep këto rezultate: 50.0% rrallë, 22.8% ndonjëherë, shpesh 9.2% dhe shumicën e kohës 18.0%.




Figura 10. A bën gabime kur merr porosi nga telefoni?




Figura 11. A e ka të vështirë të gjejë fjalët e duhura për t'u shprehur?




Figura 12. Sa shpesh mendon për zgjidhje kreative të problemit?

Rezultatet nga pyetja “Sa e ka të vështirë të shqiptojë fjalën E-le-fant?” janë si vijon: 85.1% e kanë të lehtë, 11.1% sfiduese, 2.5% vështirë dhe shumë vështirë 1.3%.




Figura 13. Sa e ka të vështirë të shqiptojë fjalën E-le-fant?

Nga të gjithë fëmijët pjesëmarrës 65.8% e kanë të lehtë të organizojnë mendimet e tyre gjatë kohës sa shkruajnë, 15.8% e shohin sfiduese këtë gjë, 9.5% vështirë dhe 8.9% shumë vështirë.




Figura 14. Kur shkruan a e ka të vështirë t'i organizojë mendimet e tij në letër?

Kurse në pyetjen “A e kanë mësuar tabelën e shumëzimit lehtësisht?” rezulton se 61.1% e fëmijëve e kanë pasur të lehtë, për 24.7% ka qenë sfiduese, 7.3% vështirë dhe shumë vështirë 7.0%.






Figura 15. A ka mësuar tabelën e shumëzimit lehtësisht?

Pyetja për vështirësinë e recitimit të alfabetit ka këto rezultate: 50.9% e fëmijëve e kanë të lehtë, sfiduese është për 24.1% të tyre, 16.8% vështirë dhe 8.2% e kanë shumë të vështirë të recitojnë alfabetin.

39.9% e fëmijëve pjesëmarrës e kanë të lehtë të lexojnë me zë të lartë, për 23.4% të lexuarit zëshëm është sfiduese, 21.5% vështirë dhe shumë vështirë 15.2% e tyre.



*Figura 16. Sa vështirë e ka të recitojë alfabetin?*



*Figura 17. Sa vështirë e ka të lexojë zëshëm?*

Suksesi i 316 fëmijëve pjesëmarrës në tri lëndët kryesore rezulton kështu: 41.26% janë të shkëlqyeshëm (5), 32.26% me sukses shumë mirë (4), mirë (3) 17.93%, mjaftueshëm (2) 6.43% kurse me sukses të pamjaftueshëm (1) 2.12%.




Figura 18. Suksesi i përgjithshëm i fëmijëve në tri lëndët kryesore

Ndërsa nëse flasim vetëm për fëmijët me vështirësi në të lexuar atëherë suksesi i tyre në tri lëndët kryesore rezulton si vijon: të shkëlqyeshëm (5) janë 7.6%, me sukses shumë mirë (4) 13.2%, mirë (3) 36.6%, mjaftueshëm (2) 34.6% dhe me sukses të pamjaftueshëm (1) janë vlerësuar gjithsej 8.3% e tyre.




Figura 19. Suksesi i fëmijëve me vështirësi në tri lëndët kryesore

Gjatë analizimit të të dhënave është bërë edhe analiza korrelacionare e cila na ndihmon të kuptojmë ndërlidhjen ndërmjet variablave të pyetësorit dhe përgjigjeve që kanë dhënë respondentët për to. Për të përcaktuar këto marrëdhënie u përdor korrelacioni i Pearson-it, ku nga rezultatet e fituara kuptojmë se mes variablave ka lidhje shumë të forta pozitive.

Tabela 3.

*Analiza korrelacionare mes variablave “A e ka të vështirë të gjejë fjalët e duhura për t’u shprehur?” dhe “Kur shkruan a e ka të vështirë t’i organizojë mendimet në letër?”*

		A e ka të vështirë të gjejë fjalët e duhur për t’u shprehur?	Kur shkruan a e ka të vështirë t’i organizojë mendimet në letër?
A e ka të vështirë të gjejë fjalët e duhura për t’u shprehur?	Pearson Correlation	1	.678**
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	316	316
Kur shkruan a e ka të vështirë t’i organizojë mendimet në letër?	Pearson Correlation	.678**	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	316	316

Në tabelën sipër tregohet ndërlidhja signifikante në mes dy variablave, a e ka të vështirë të gjejë fjalët e duhura për t’u shprehur dhe kur shkruan a e ka të vështirë t’i organizojë mendimet në letër ( $r = .678$ ,  $N=316$   $p<.000$ ).

Kjo nënkupton se sa më të vështirë ta ketë të gjejë fjalët e duhura për t’u shprehur aq më vështirë do t’i organizojë mendimet në letër.



Tabela 4.

*Analiza korrelacionare mes variablave “A i ngatërron rreshtat gjatë leximit?” dhe “A i rilexon paragrafët për t’i kuptuar ato më mirë?”*

		A i ngatërron rreshtat gjatë leximit?	A i rilexon paragrafët për t’i kuptuar ato më mirë?
A i ngatërron rreshtat gjatë leximit?	Pearson Correlation	1	.625**
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	316	316
A i rilexon paragrafët për t’i kuptuar ato më mirë?	Pearson Correlation	.625**	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	316	316

Në tabelën 4 tregohet ndërlidhje signifikante në mes variablave, a i ngatërron rreshtat gjatë leximit dhe a i rilexon paragrafët për t’i kuptuar ato më mirë ( $r = .625$ ,  $N = 316$ ,  $p < .000$ ), e kjo na lë të kuptojmë se sa më shumë fëmija i ngatërron rreshtat kur lexon aq më tepër i rilexon ato për t’i kuptuar.

Tabela 5.

*Analiza korrelacionare mes variablave “Sa vështirë e ka të recitojë alfabetin?” dhe “A e ka të vështirë të lexojë zëshëm?”*

		Sa vështirë e ka të recitojë alfabetin?	A e ka të vështirë të lexojë zëshëm?
Sa vështirë e ka të recitojë alfabetin?	Pearson Correlation	1	.685**
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	316	316
A e ka të vështirë të lexojë zëshëm?	Pearson Correlation	.685**	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	316	316

Në variablat, sa vështirë e ka të recitojë alfabetin dhe a e ka të vështirë të lexojë zëshëm kemi këtë ndërlidhje ( $r=.685$ ,  $N=316$ ,  $p<.000$ ) që do të thotë se sa më shumë vështirësi të has në recitim të alfabetit aq më vështirë do të ketë të lexojë zëshëm, e paraqitur përmes tabelës me numër 5.

Tabela 6.

*Analiza korrelacionare mes variablave "A ka pengesa në tregim të drejtimit majtas dhe djathtas?" dhe "A ndihet habitur duke lexuar udhëzimet e hartës?"*

		A ka pengesa në tregim të drejtimit majtas dhe djathtas?	A ndihet i habitur duke lexuar udhëzimet e hartës?
A ka pengesa në tregim të drejtimit majtas dhe djathtas?	Pearson Correlation	1	.603**
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	316	316
A ndihet i habitur duke lexuar udhëzimet e hartës?	Pearson Correlation	.603**	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	316	316

Ndërlidhje signifikante tregohet edhe në tabelën 6 ndërmjet variablave, a ka pengesa në tregim të drejtimit majtas dhe djathtas, karshi variablës a ndihet i habitur duke lexuar udhëzimet e hartës ( $r= .603$ ,  $N=316$ ,  $p<.000$ ), që do të thotë se aq sa do të ketë vështirësi të orientohet majtas dhe djathtas, po aq do të ndihet i habitur kur lexon udhëzimet e hartës.

Analiza korrelacionare e paraqitur në tabelën 7 tregon se egziston ndërlidhje signifikante në mes variablave, a i ngatërron fjalët e ngjashme vizuale si ditë dhe datë dhe a i ngatërron emrat e objekteve si p.sh tavolinë në vend të karrigës ( $r= .635$ ,  $N=316$ ,  $p<.000$ ).

Tabela 7.

*Analiza korrelacionare mes variablave "A i ngatërron fjalët e ngjashme vizuale si ditë dhe datë?" dhe "A i ngatërron emrat e objekteve si psh tavolinë në vend të karrigës?"*

		A i ngatërron fjalët e ngjashme vizuale si ditë dhe datë?	A i ngatërron emrat e objekteve si psh tavolinë në vend të karrigës?
A i ngatërron fjalët e ngjashme vizuale si ditë dhe datë?	Pearson Correlation	1	.635**
	Sig. (2-tailed)		.000
	N	316	316
A i ngatërron emrat e objekteve si psh tavolinë në vend të karrigës?	Pearson Correlation	.635**	1
	Sig. (2-tailed)	.000	
	N	316	316

Rezultatet nga analiza e T-testit tregojnë dallimin në mes të pikëve totale dhe fëmijëve nga fshati dhe qyteti ( $t= 8291$ ,  $p= .397$ ) në dobi të fëmijëve nga qyteti. Ku fëmijët nga qyteti kanë më pak problem me të lexuarit se fëmijët nga fshati.

Gjithashtu rezultatet e këtij testi tregojnë edhe dallimin në mes të pikëve totale dhe fëmijëve sipas gjinisë ( $t= 11988$ ,  $p=.552$ ) në dobi të vajzave. Ku vajzat kanë më pak problem me të lexuarit se djemtë.

## 4. DISKUTIME

Të lexuarit është proces mjaft i rëndësishëm që konsiderohet komponent kryesor në procesin e të nxënës, i cili na ndjek gjatë gjithë jetës tonë. Ai përveç se kërkon identifikimin e fjalëve të shtypura ngërthen në vete edhe një kërkesë kyçe që është nocioni i të kuptuarit, pra marrjen dhe ndërtimin e kuptimit nga ana e lexuesit. Nevoja për të pasur aftësi dhe rrjedhshmëri në të lexuar është me rëndësi të madhe në shoqërinë e sotme (Crouch & Jakubecy, 2007). Interpretimi i ideve, leximi apo nënshkrimi i marrëveshjeve ligjore dhe të tjera aktivitete të përditshme kanë rëndësi të madhe në ditët e sotme ndaj si pasojë është i nevojshëm zotërimi i aftësisë për të lexuar. Të lexosh është aftësi, e kjo fatkeqësisht nuk zhvillohet tek secili individ. Aftësi e kufizuar për të mësuar të lexuarit, është kur fëmija ka një nivel të aftësisë nën atë që pritet për moshën kronologjike, mendore dhe nivelin arsimor, e kjo në literaturën e specializuar njihet me termin disleksi. Janë bërë shume studime lidhur me disleksinë në vende të ndryshme të botës të cilat raportojnë përqindje të larta apo të ulëta të disleksisë. Ende nuk dihet se sa njerëz kanë probleme disleksike mirëpo sipas hulumtimeve përqindja varion nga 5 deri në 21 % (Jones, 2015). Rezultatet e këtij studimi tregojnë se 39 fëmijë (12.34%) nga gjithsej 316 sa kanë marrë pjesë në hulumtim kanë probleme serioze me të lexuarit. Një hulumtim i kryer në Amerikë tregon se rreth 20% e fëmijëve kanë probleme si disleksia apo disgrafia (Richards, Grabowski, Boord, Yagle, Askren, Mestre, Robinson, Welker, Gulliford, Nagy, Berninger, 2015).

Për fat të keq, vështirësitë në të lexuar zakonisht vërehen tek fëmijët në shkollat fillore, veçanërisht tek djemtë (Feder & Majnemer, 2007). Rezultatet e këtij studimi tregojnë që nga 316 fëmijët pjesëmarrës 153 janë meshkuj ose 48.4% ndërsa 163 janë femra apo 51.6%. Ndërsa 12.34% e tyre kanë vështirësi në të lexuar, 4.11% femrat dhe 8.23% meshkuj. Ky rezultat nënkupton se vërtetohet hipoteza e hulumtimit “Djemtë janë më të prekur se vajzat me disleksi”. Se djemtë janë më të prekur se vajzat me disleksi dhe disgrafi, tregohet edhe në 2013 ku 9% e djemve dhe 6% e vajzave nga 3 deri në 17 vjeç rezultuan të kenë probleme të fushës së disleksisë apo disgrafisë (Jones, 2015). Sipas një hulumtimi të kryer në Greqi nga 598 nxënës pjesëmarrës, 7.6% prej tyre kanë qenë meshkuj dhe 3.8% femra (Vlachos, Avramidis, Dedousis, Ntalla & Giannakopoulou, 2013).

Të lexuarit është një aftësi komplekse që kërkon mësim formal dhe elementar në tre vitet e para të shkollës fillore. Ai është më shumë se vetëm një akt motorik, është një proces njohës për zhvillimin e aftësive në përgjithësi (Abbott, Berninger & Fayol, 2010).

Shkolla, si institucion përmes të cilit përcillen dhe përvetësohen dije, e sheh të lexuarin si çelësin e sukseseve të çdo individi në të gjitha moshat e edukimit të tij. Fëmijët e shkollave fillore zakonisht shpenzojnë deri në 50% të kohës në shkollë të angazhuar në detyra që kërkojnë të lexuar, disa prej të cilave duhet të përfundojnë në kohë të kufizuar (Tseng & Chow, 2000). Duke marrë parasysh se burim kryesor i procesit mësimor janë tekstet shkollore, të lexuarit është pjesë e pandashme e tij.

Disleksia mund të ketë efekte negative në suksesin e një nxënësi në shkollë (Humphrey & Mullins, 2002). Vështirësitë në të lexuar mund të errësojnë aftësitë e fëmijës në fusha të tjera, duke e bërë suksesin e tyre në shkollë më të dobët dhe më të vështirë për ta arritur. Fëmijët me probleme të tilla zakonisht kanë vështirësi për të fituar njohuritë e nevojshme dhe për të kryer detyrat gjatë viteve të shkollës fillore, të cilat mund të pengojnë progresin akademik, të shkaktojë ulje të vetëbesimit dhe probleme me sjelljen (Shalev, Auerbach, Manor & Gross-Tsur, 2000). Ata mund të mësojnë shumë më pak nga një detyrë, sepse ju duhet të përqendrohen në të lexuar në vend se të kuptojnë përmbajtjen e saj. Pasi që kalojnë më shumë kohë në një detyrë sesa moshatarët e tyre, këta nxënës kuptojnë më pak thelbin e detyrës. Nuk është çudi, nëse ata humbasin vetëbesimin dhe vuajnë nga paaftësia për të mësuar kur të lexuarit është pengesa e tyre kryesore (Jones, 2015).

Rezultatet e këtij studimi tregojnë që në suksesin në tri lëndët kryesore të të gjithë fëmijëve pjesëmarrës në hulumtim 41.26% janë të shkëlqyeshëm (5), 32.26% me sukses shumë mirë (4), mirë (3) janë gjithsej 17.39%, mjaftueshëm (2) 6.43% dhe pamjaftueshëm (1) me përqindje 2.12%. Ndërsa kur flasim për fëmijët me vështirësi në të lexuar kemi këto rezultate: 7.6% e tyre janë të shkëlqyeshëm (5), 13.2% me sukses shumë mirë (4), mirë (3) 36.6%, mjaftueshëm (2) 34.6% dhe me sukses të pamjaftueshëm (1) gjithsej 8.3% prej tyre. Hipoteza “Vështirësia në të lexuar ndikon në suksesin e nxënësve në shkollë” vërtetohet nëse shikohen rezultatet e këtyre nxënësve në suksesin nga tri lëndët kryesore.

## 5.PËRFUNDIME

Nga të gjeturat e këtij hulumtimi arrijmë në përfundim se përqindja e fëmijëve me vështirësi në të lexuar në rajonin e Mitrovicës është mjaft e lartë. Suksesi i këtyre fëmijëve është dukshëm më i dobët krahasuar me suksesin e përgjithshëm të fëmijëve të tjerë, gjë që tregon se disleksia ndikon negativisht në suksesin e fëmijëve në shkollë. Gjetjet e hulumtimit rekomandojnë informimin sa më të shpejtë të mësimit për problemet e fushës së disleksisë si dhe fushave të tjera, që fëmijët me disleksi të mos dallohen nga fëmijët e tjerë vetëm për shkak të kësaj vështirësie që kanë. Fëmijët që kanë këto vështirësi shumë herë mbesin të paidentifikuar nëse ata nuk kanë probleme shumë të dukshme, ngase etiketohen si "mendërisht prapa" ose "nuk janë të interesuar për të lexuar" nga mësuesit ose nga vetë prindërit (Jones, 2015). Ndaj atyre u duhen më shumë njohuri në lidhje me disleksinë dhe problemet e tjera të ngjashme në mënyrë që të rekomandojnë nxënësit të profesionistët e duhur për këto probleme. Është shumë e rëndësishme për të përcaktuar nëse një fëmijë me disleksi mund të ketë gjithashtu disgrafi dhe të kërkojë ndihmë të veçantë për lexim dhe shkrim (Wright & Wright, 2008).

Zbulimi i vështirësisë në të lexuar është shumë me rëndësi të bëhet në moshë sa më të hershme, në mënyrë që fëmijët të marrin ndihmën e nevojshme ose udhëzime të specializuara në këtë drejtim në të gjitha aftësitë përkatëse që ndërhyjnë në mësimin e tyre të shprehjes (Martin, Foels, Clanton & Moon, 2004).

Prindërit e sidomos mësimit luajnë rol kyç në procesin e identifikimit të disleksisë tek fëmijët dhe nxënësit e tyre ndaj ata duhet të jenë të informuar rreth kësaj vështirësie që të mund tu japin mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme atyre (Tunmer & Greaney, 2010). Kjo është natyrisht e dëshirueshme, për arsye se nuk është vonë gjatë viteve të moshës shkollore për të ndërhyrë në përmirësimin e aftësive të mangëta të nxënësit duke i siguruar atyre mjedis të përshtatshëm. Shumë shkolla identifikojnë nxënësit që kanë probleme me shkrimin dhe leximin por vazhdimisht dështojnë të bëjnë përparim normal në njërin ose tjetrin aftësi të të mësuarit. Roli i mësimit konsiston në gjetjen e rrugëve të duhura për të rritur cilësinë dhe performancën e çdo nxënësi pavarësisht vështirësive që hasin. Që të arrihet kjo mësimit kanë nevojë për trajnim për të adresuar nevojat e veçanta të fëmijëve (Rajakumar & Hema, 2005).

Sigurimi i informacionit teorik mbi bazën biologjike të vështirësive në të nxënë u ndihmon mësime dhënëve të zbatojnë këto njohuri përgjatë punës në klasë në fuqizimin dhe përmirësimin e shkrim-leximit për nxënësit me disleksi ose disgrafi (Berninger & Wolf, 2009). Mësuesit kanë nevojë për njohuri të praktikave efektive për dizajnimin, zbatimin dhe vlerësimin e mësimit të diferencuar në klasën e arsimit të përgjithshëm. Individualizimi i mësimit do të ishte shumë efektiv, do të ishin më pak nxënës që cilësohen me vështirësi ose që referohen për arsim special, organizimi i aktiviteteve që përmirësojnë aftësitë sociale të fëmijës dhe forcojnë lidhjet e tij me bashkëmoshatarët si dhe patjetër element për tu ardhur në ndihmë fëmijëve me vështirësi në të lexuar është bashkëpunimi i prindërve dhe mësime dhënëve (Lesaux, Lipka & Siegel 2006). Çdo fëmijë është unik, prandaj kjo kërkon një formë, strategji apo teknikë të veçantë të punës me ta. Me fëmijët që kanë këto vështirësi nuk mund të punohet më të njëjtin program të përgatitur për një fëmijë tjetër, sado të ngjashëm mund të duken.

Puna me fëmijë sado sfiduese që mund të jetë, në të njëjtën kohë është edhe frymëzuese prandaj mësime dhënësit kurrë nuk duhet të ndalen së punuari me nxënës, nuk duhet të humbasin motivimin për punën që po e bëjnë si dhe duhet të reflektojnë pozitivitet para nxënësve. Ata në vazhdimësi duhet të jenë në kërkim të metodave të ndryshme që kanë për qëllim gjithëpërfshirjen e nxënësve duke mos anashkaluar asnjë prej tyre dhe për t'i motivuar ata në çdo hap që e bëjnë, pavarësisht pengesave që i hasin në rrugëtimin e tyre.

## LITERATURA

Abbott, R. D., Berninger, V., & Fayol, M. (2010). Longitudinal Relationships of Levels of Language in Writing and between Writing and Reading in Grades 1 to 7. *Journal of Educational Psychology*, 102: 281-298.

Andersson, B. (2003). Dyslexia: terms, official regulations and approach. The educational material of the future. Sweden: Swedish Handicap Institute

Berninger, V., & Wolf, B. (2009). Teaching students with dyslexia and dysgraphia: Lessons from teaching and science. Baltimore, MD: Paul H. Brookes.

Burden, R. (2005). Dyslexia & Self-concept. Seeking a Dyslexic Identity. London: Whurr Publishers Ltd.

Cortiella, C., & Horowitz, S. H. (2014). The State of Learning Disabilities: Facts, Trends and Emerging Issues. New York: National Center for Learning Disabilities

Crouch, A. L., & Jakubecy, J. J. (2007). Dyslexia: How it affects a student's performance and what can be done about it. TEACHING Exceptional Children Plus, Article 5

Dhanda, A., & Jagawat, T. (2013). Prevalence and Pattern of Learning Disabilities in School Children. *Delhi Psychiatry Journal*. Vol.16, No.12. 1-5

Feder, K. P., & Majnemer, A. (2007). Handwriting and Reading Development, Competency, and Intervention. *Developmental Medicine & Child Neurology*, 49, 312-331

Graham, S., & Harris, K. R. (2000). The role of self-regulation and transcription skills in writing and writing development. *Educational Psychologist*, 35, 3–12.

Gjokutaj, M. (2014). Didaktika e gjuhës shqipe, Shkronjë pas shkronje, Tiranë



Harrison, A. G., Rosenblum, Y., Currie, S. (2010). Examining unusual digit span performance in a population of postsecondary students assessed for academic difficulties. *Assessment*, 17, 283–293.

Humphrey, N. (2002). Teacher and pupil ratings of self-esteem in developmental dyslexia. *British Journal of Special Education*, 29 (1), 29-36.

Humphrey, N., & Mullins, P. M. (2002). Personal constructs and attribution for academic success and failure in dyslexia. *British Journal of Special Education*, 29(4), 196-203.

Jones, S. (2015). *Dyslexia Accommodations and Modifications. The educator's guide to learning disabilities and ADHD.* Washington, D.C: WETA

Lesaux, N. K., Lipka, O., Siegel, L. S. (2006) Investigating cognitive and linguistic abilities that influence the reading comprehension skills of children from diverse linguistic backgrounds. *Reading and Writing*. 19:99–131.

Mathes, P., & Fletcher, J. (2008). Dyslexia. *Encyclopedia of educational psychology*, 289-294

Marentette, P. (2011). What is dysgraphia? *Development of education in Kenya* 51, 25-36

Martin, R. P., Foels, P., Clanton, G., & Moon, K. (2004). Season of Birth Is Related to Child Retention Rates, Achievement, and Rate of Diagnosis of Specific LD. *Journal of Learning Disabilities*, 37, 307-317

McNulty, A. M. (2003). Dyslexia and the life course. *Journal of learning disabilities*, 36 (4), 363-381

Meece, L. J., & Daniels, H. D. (2008). *Child & Adolescent Development for Educators*, McGraw Hill, New York. 94-97

Moats, L., & Dakin, K. (2008). Basic facts about dyslexia and other reading problems. Baltimore, MD: International Dyslexia Association.

Mogasale, V. V., Patil, V. D., Patil, N. M., & Mogasale, V. (2012). Prevalence of specific learning disabilities among primary school children in a South Indian City. *Indian J Pediatr*, 79: 482-97

Rajkumar, R., & Hema, G. (2005). Department of education, Periyar University, Salem-11

Richards, R. (2000). The source for dyslexia and dysgraphia. East Moline, IL: LinguiSystems.

Richards, T. L., Grabowski, T. J., Boord, P., Yagle, K., Askren, M., Mestre, Z., Robinson, P., Welker, O., Gulliford, D., Nagy, W., & Berninger, V. (2015). Contrasting brain patterns of writing-related DTI parameters, fMRI connectivity, and DTI-fMRI connectivity correlations in children with and without dysgraphia or dyslexia. *NeuroImage: Clinical*, 17 (2), 65-91

Ridsdale, J. (2004). Dyslexia and self-esteem. In M. Turner and J. Rack (Eds.) *The Study of Dyslexia*. N.Y. Kluwer Academic, Plenum Publishers, 249-279

Rosenblum, S., Weiss, P. L., & Parush, S. (2004). Handwriting evaluation for developmental dysgraphia: Process versus product. *Reading and Writing*, 17(5), 433-458

Shalev, R. S., Auerbach, J., Manor, O. & Gross-Tsur, V. (2000). Developmental dyscalculia: prevalence and prognosis. *Child Adolesc Psychiatry*, 9. P. 58-64

Tseng, M. H. & Chow, S. M. K. (2000). Perceptual motor function of school-age children with slow handwriting and reading speed. *American Journal of Occupational Therapy*, 54, 83-88

Tunmer, W., & Greaney, K. (2010). Defining Dyslexia. *Journal of Learning Disabilities*, 43 (3), 229-243.

Wright, P. W. D., & Wright P. D. (2008). Diagnosing dysgraphic and related learning disabilities. *International Journal of Education and Research* Vol. 3 No. 2 February 2015

Vlachos, F., Avramidis, E., Dedousis, G., Chalmpe, M., Ntalla, I., & Giannakopoulou, M. (2013). Prevalence and Gender Ratio of Dyslexia in Greek Adolescents and Its Association with Parental History and Brain Injury. *American Journal of Educational Research*, Vol. 1, No. 1, 22-25

## SHTOJCAT

### SHTOJCA A



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**'ISA BOLETINI'**  
*Rr.Parku Industrial, p.n. 40000 Mitrovicë*  
*Republika e Kosovës*  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

---

### FORMULAR PAJTIMI

#### **I/E nderuar,**

Fakulteti i Edukimit të Universitetit të Mitrovicës, në organizimin e studimeve ka të paraparë zhvillimin e punimit të Diplomës. Në këtë kuadër, unë kam zgjedhur të zhvilloj hulumtimin me temë “Nxënësit me vështirësi në të lexuar në klasët e pesta në Mitrovicë dhe ndikimi i kësaj vështirësie në suksesin e tyre”.

Formulari ju ofrohet për tu pajtuar që të jeni pjesë e hulumtimit. Ne ju sigurojmë që të dhënat e mbledhura në këtë studim, do të përdoren vetëm për realizimin e qëllimit të këtij studimi. Ju mund të zgjidhni të jeni pjesëmarrës në kushte anonimiteti ose konfidencialiteti. Ne respektojmë zgjedhjen tuaj.

Duke besuar dhe respektuar në bashkëpunimin me ju, ju falënderojmë.

Ju lutem nënshkruani konfirmimin tuaj.

Ofruesi i formularit

-----

-----

Ju faleminderit!

## SHTOJCA B



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**'ISA BOLETINI'**  
 Rr.Parku Industrial, p.n. 40000 Mitrovicë  
 Republika e Kosovës  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

## PYETËSOR

I/e nderuar!

Duke ju falënderuar për pjesëmarrjen në këtë hulumtim, ju lusim që ta plotësoni këtë pyetësor. Përgjigjet dhe të dhënat tuaja do të jenë plotësisht konfidente dhe nuk lejohet kurrfarë reklamimi i tyre. Gjithë çfarë na intereson është numri i fëmijëve me probleme në të lexuar. Andaj ju lusim që përgjigjet tuaja të jenë sa më të sinqerta.

Emri dhe mbiemri: \_\_\_\_\_

Gjinia: (M) (F)

Shkolla: \_\_\_\_\_

Klasa \_\_\_\_\_

		Rrallë	Ndonjëherë	Shpesh	Shumicën e kohës	Totali
1.	A i ngatërron fjalët e ngjashme vizuale si ditë dhe datë?	3	6	9	12	
2.	A mos i ngatërron rreshtat gjatë leximit?	2	4	6	8	
3.	A i ngatërron emrat e objekteve si p.sh tavolinë në vend të karrigës?	1	2	3	4	
4.	A ka pengesa në tregimin e drejtimit majtas dhe djathtas?	1	2	3	4	
5.	A ndihet i habitur duke lexuar udhëzimet e hartës?	1	2	3	4	
6.	A i rilexon paragrafët për t'i kuptuar më mirë ato?	1	2	3	4	
7.	A ndihet i hutuar gjatë dhënies së disa informatave përnjëherë?	1	2	3	4	
8.	A bën gabime kur merr porosi nga telefoni?	1	2	3	4	
9.	A e ka të vështirë të gjejë fjalët e dhura për t'u shprehur?	1	2	3	4	
10.	Sa shpesh mendon për zgjidhje kreative të problemit?	1	2	3	4	
		Lehtë	Sfiduese	Vështirë	Shumë vështirë	Totali
11.	Sa e ka të vështirë të shqiptojë fjalën E-le-fant?	3	6	9	12	
12.	Kur shkruan a e ka vështirë t'i organizojë mendimet në letër?	2	4	6	8	
13.	A e mëson tabelën e shumëzimit lehtësisht?	2	4	6	8	
14.	Sa lehtë e ka të recitoj alfabetin?	1	2	3	4	
15.	Sa vështirë e ka të lexojë zëshëm?	1	2	3	4	

Mësuesi/ja \_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_